



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 7.3.2025

Nr. 1672 prot.

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve", të ndryshuar".
2. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 13, datë 12.11.2024, "Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit".
3. Projektvendim "Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
4. Projektvendim "Për disa shtesa në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator "Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit", i ndryshuar".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacioneve shoqëruese.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

